



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-05

**Prokurori kundër Salih Mustafës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, Gjykatës Rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 3 qershor 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i Redaktuar Publik i**

**Vendimit në Bazë të Rregullave 132 dhe 149 të Rregullores së Procedurës dhe  
Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës në Lidhje me Prova të  
Kërkuara nga Trupi Gjykses**

---

**T'i njoftohet:**

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtjes së të Akuzuarit**  
Julius von Bone

**Mbrojtëses së Viktimave**  
Anni Pues

**TRUPI GJYKUES I** (Trupi Gjykues) lëshon këtë vendim në bazë të rregullave 132 dhe 149 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja) lidhur me provat e kërkuara nga Trupi Gjykues.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 21 mars 2022, me kërkesë të mbrojtëses së viktimave,<sup>1</sup> Trupi Gjykues caktoi *Instituut voor Mensenrechten en Medisch Onderzoek* (Instituti për Të Drejtat e Njeriut dhe Vlerësim Mjekësor - iMMO) për të bërë një vlerësim të gjendjes psikiatrike dhe një vlerësim mjekësor të dëmit fizik dhe psikologjik dhe lëndimeve të pësura nga viktimat 08/05, 09/05 dhe 10/05 [REDAKTUAR] dhe për të përgatitur një aktekspertizë mjekësore.<sup>2</sup>
2. Më 28 prill 2022, mbrojtësja e viktimave e informoi Trupin Gjykues se nuk ishte e mundur të kryhej ekzaminimi i viktimës 10/05 në të ardhmen e afërt [REDAKTUAR] dhe, për rrjedhojë, tërhoqi kërkesën e saj në lidhje me të.<sup>3</sup>
3. Më 20 maj 2022, Trupi Gjykues lëshoi dy urdhra për paraqitjen e provave [REDAKTUAR] dhe udhëzoi Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) të dorëzonte dhe të zbatonte urdhrat (Urdhrat për Dorëzimin e Provave).<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05, F00297, Mbrojtësja e Viktimave, *Kërkesë e Mbrojtëses së Viktimave në pajtim me Vendimin e Dytë në lidhje me Zhvillimin e Gjykimit të datë 21 janar 2022, 24 janar 2022, konfidencial, para. 23-26, 31(a)*. Versioni i redaktuar publik u protokollua të njëjtën ditë, F00297/RED. Nuk u parashtruan përgjigje nga Prokurori i Specializuar ose Mbrojtja e Salih Mustafës

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 21 mars 2022, publik, f. 2532, rreshti 11 deri në f. 2534, rreshti 4; *shih më tej* Transkripti i seancës, 9 mars 2022, publik, f. 2519, rreshti 18 deri në f. 2521, rreshti 24.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-05, F00398, Mbrojtësja e Viktimave, *Raporti i Dytë i Mbrojtëses së Viktimave në pajtim me Urdhrin Gojor të 21 marsit 2022 dhe Përgjigje ndaj Urdhrit Gojor të 11 prillit 2022, 28 prill 2022, konfidencial, para. 7-9, 11(b)*. Versioni i redaktuar publik u protokollua më 21 maj 2022, F00398/RED.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-05, F00412, Trupi Gjykues I, *Urdhër për Dorëzimin e Provave* [REDAKTUAR], 20 maj 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00413, Trupi Gjykues I, *Urdhër për Dorëzimin e Provave*

4. Më 24 maj 2022, mbrojtësja e viktimave dorëzoi raportet mjekësore të përgatitura nga iMMO-ja në lidhje me viktimat 08/05 dhe 09/05 (aktekspertizat e iMMO-s).<sup>5</sup> Trupi Gjykses nuk ka marrë asnjë njoftim nga palët brenda afatit të përcaktuar në rregullën 149(2) të Rregullores që kundërshton kualifikimet e dëshmitarëve ekspertë të iMMO-s apo aktekspertizat e tyre, apo që bën të ditur nëse dëshirojnë t'i bëjnë pyetje dëshmitarëve ekspertë të iMMO-s.

5. Më 2 qershor 2022, ZPS-ja raportoi për zbatimin e Urdhrave për Dorëzimin e Provave.<sup>6</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Trupi Gjykses vë në dukje nenin 40(6)(e) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 9(5)(a), 132 dhe 149 të Rregullores.

7. Trupi Gjykses rikujton vendimin e tij të mëparshëm se, pas dorëzimit të aktekspertizave, zbatohet procedura e përcaktuar në rregullën 149(2)-(5) të Rregullores.<sup>7</sup> Rregulla 149(3) e Rregullores përcakton se, “në qoftë se pala kundërshtare pranon aktekspertizën e dëshmitarit ekspert ose pjesë të saj, kjo aktekspertizë ose pjesë të saj mund të pranohen nga Trupi Gjykses si provë pa thirrur dëshmitarin ekspert që të dëshmojë duke qenë i pranishëm”.

---

[REDAKTUAR], 20 maj 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versionet e redaktuara konfidenciale do të parashtrohen më vonë.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-05, F00417, Mbrojtësja e Viktimave, *Parashtrim i Aktekspertizave Mjekësore lidhur me Viktimat 08/05 dhe 09/05 prej Mbrojtëses së Viktimave*, 24 maj 2022, publik, me Shtojcat 1 dhe 2, rreptësisht konfidenciale.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-05, F00427, Prokurori i Specializuar, *Raport i Prokurorisë në pajtim me Urdhrin KSC-BC-2020-05/F00412*, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00428, Prokurori i Specializuar, *Raport i Prokurorisë në pajtim me Urdhrin KSC-BC-2020-05/F00413*, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 9 mars 2022, publik, f. 2521, rreshtat 16-18.

### III. ANALIZË

#### A. AKTEKSPERTIZAT E IMMO-S

8. Trupi Gjykses vëren se viktimat 08/05 dhe 09/05 kanë status të dyfishtë si viktima dhe si dëshmitarë në çështjen gjyqësore aktuale [REDAKTUAR] dhe kanë dhënë dëshmi para Trupit Gjykses në lidhje me [REDAKTUAR].<sup>8</sup> Aktekspertizat e iMMO-s bëjnë një vlerësim mjeko-ligjor (fizik dhe psikologjik) se deri në çfarë mase simptomat mjekësore të shfaqura nga viktimat 08/05 dhe 09/05 përkojnë me përshkrimin e tyre të ngjarjeve.<sup>9</sup> Ekspertët mblodhën informacion mbi shëndetin fizik dhe mendor të viktimave [REDAKTUAR] dhe kryen një ekzaminim fizik, psikiatrik dhe psiko-diagnostikues për të hetuar më tej simptomat e pretenduara duke kërkuar prova objektive.<sup>10</sup> Trupi Gjykses konsideron se, duke marrë parasysh sa më lart, aktekspertizat e iMMO-s janë të domosdoshme për përcaktimin e të vërtetës në çështjen gjyqësore aktuale dhe vendos t'i pranojë si prova në pajtim me rregullën 132 të Rregullores.

9. Trupi Gjykses vëren se palët nuk kanë parashtruar asnjë njoftim sipas rregullës 149(2) të Rregullores brenda afatit të përcaktuar në atë rregull, që kundërshton kualifikimet e dëshmitarëve ekspertë apo aktekspertizat e tyre, dhe nuk kanë shprehur dëshirën për t'i bërë pyetje dëshmitarëve ekspertë. Për rrjedhojë, në pajtim me rregullën 149(3) të Rregullores, Trupi Gjykses mund të pranojë aktekspertizat e iMMO-s si prova pa thirrur dëshmitarët ekspertë që të dëshmojnë duke qenë të pranishëm. Në pajtim me "Vendimin mbi Parashtrimet dhe Pranueshmërinë e

---

<sup>8</sup> [REDAKTUAR].

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-05, F00417/A01, Mbrojtësja e Viktimave, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktekspertizave Mjekësore lidhur me Viktimat 08/05 dhe 09/05 prej Mbrojtëses së Viktimave, 24 maj 2022, rreptësisht konfidenciale, f. 2; F00417/A02, Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktekspertizave Mjekësore lidhur me Viktimat 08/05 dhe 09/05 prej Mbrojtëses së Viktimave, 24 maj 2022, rreptësisht konfidenciale, f. 2.

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-05, F00417/A01, Mbrojtësja e Viktimave, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktekspertizave Mjekësore lidhur me Viktimat 08/05 dhe 09/05 prej Mbrojtëses së Viktimave, 24 maj 2022, rreptësisht konfidenciale, f. 8, 11-17; F00417/A02, Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktekspertizave Mjekësore lidhur me Viktimat 08/05 dhe 09/05 prej Mbrojtëses së Viktimave, 24 maj 2022, rreptësisht konfidenciale, f. 8, 11-17.

Provave” të Trupit Gjykses, Trupi Gjykses vendos të mos marrë një vendim të veçantë lidhur me pranueshmërinë dhe gjykon se aktekspertizat e dëshmitarëve ekspertë të iMMO-s janë në dispozicion të Trupit Gjykses për kuvendimet mbi vendimin për fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit.<sup>11</sup>

#### B. MATERIALET NË LIDHJE ME [REDAKTUAR] DHE [REDAKTUAR]

10. Përmes urdhrave për dorëzimin e provave, Trupi Gjykses urdhëroi [REDAKTUAR],<sup>12</sup> dhe [REDAKTUAR], të cilët u përmendën të dy gjatë dëshmimeve përkatëse të dëshmitareve.<sup>13</sup> Këta urdhra u lëshuan pa paragjykuar vendimin e Trupit Gjykses nëse në fund do të kërkonte paraqitjen e këtyre provave në pajtim me rregullën 132 të Rregullores. [REDAKTUAR].<sup>14</sup>

11. Pasi shqyrtoi materialet, Trupi Gjykses vendosi të mos përfshinte [REDAKTUAR] apo [REDAKTUAR] si prova. Kjo nuk cenon të drejtën e palëve për kërkesa për të pranuar në prova materialin (ose pjesë të tij).

12. Së fundi, Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në të dorëzojë kërkesë për paraqitjen e kundërprovave shtesë pas provave të kërkuara nga Trupi Gjykses, nëse dëshiron, deri **të martën, 7 qershor 2022**. Trupi Gjykses e konsideron të përshtatshme të shkurtojë afatin për përgjigjet ndaj kërkesave të tilla në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, deri **të enjten, 9 qershor 2022**. Gjithashtu, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen të parashtrojë kërkesë për paraqitjen e kundërprovave, ndër të tjera në lidhje

---

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-05, F00169, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Parashtrimet dhe Pranueshmërinë e Provave*, 25 gusht 2021, publik, para. 21, 24.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-05, F00413, Trupi Gjykses I, *Urdhër për Dorëzimin e Provave* [REDAKTUAR], 20 maj 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 4.

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-05, F00412, Trupi Gjykses I, Trupi Gjykses I, *Urdhër për Dorëzimin e Provave* [REDAKTUAR], 20 maj 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 4.

<sup>14</sup> [REDAKTUAR]; KSC-BC-2020-05, F00427, Prokurori i Specializuar, *Raport i Prokurorisë në Pajtim me Urdhrin KSC-BC-2020-05/F00412*, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00428, Prokurori i Specializuar, *Raport i Prokurorisë në Pajtim me Urdhrin KSC-BC-2020-05/F00413*, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

me aktekspertizat e iMMO-s nëse ka, deri **të enjten, 9 qershor 2022**, dhe shkurton afatin për përgjigjet ndaj kërkesave të tilla, në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, deri të **hënën, 13 qershor 2022**.

#### IV. VENDIM

13. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **VENDOS** pranimin e aktekspertizave të iMMO-s (F00417/A01 dhe F00417/A02) si prova;
- b. **URDHËRON** Administratoren t'u caktojë numra të provave materiale aktekspertizave të iMMO-s dhe t'i klasifikojë ato si konfidenciale;
- c. **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë versionet e redaktuara konfidenciale të parashtrimeve të protokolluara F00427 dhe F00428, pa shtojcat e tyre, ose të kërkojë riklasifikimin e tyre, deri **të mërkurën, 8 qershor 2022**;
- d. **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë kërkesë për paraqitjen e kundërprovave shtesë pas provave të kërkuara nga Trupi Gjykses, nëse dëshiron, deri **të martën, 7 qershor 2022**, dhe përgjigjet të dorëzohen deri **të enjten, 9 qershor 2022**; dhe
- e. **URDHËRON** Mbrojtjen të parashtrorë kërkesë për paraqitjen e kundërprovave, ndër të tjera në lidhje me Aktekspertizën e iMMO-së, nëse ka, deri **të enjten, 9 qershor 2022**, dhe përgjigjet të dorëzohen deri të **hënën, 13 qershor 2022**.

\_\_\_\_\_/nënshkrimi/\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia**  
**Kryegjykatëse**

\_\_\_\_\_/nënshkrimi/\_\_\_\_\_  
**Gjykatës Zhilber Biti**

\_\_\_\_\_/nënshkrimi/\_\_\_\_\_  
**Gjykatës Roland Dekers**

E premte, 3 qershor 2022

Në Hagë, Holandë.